



Trupi Koordinues i Qeverisë së Republikës së Serbisë për komunat Preshevë, Bujanoc dhe Medvegjë

# **Informata mbi aktivitetet e Trupit bashkërendues**

(qershor – dhjetor 2010)

Në pajtim me prioritetet dhe qëllimet e definuara, Trupi bashkërendues shënoi suksese të rëndësishme gjatë periudhës së kaluar:

**a) Në fushën politike** – U nënshkrua marrëveshja mbi pushtetin multietnik në komunën e Buajnocit. Krahas kryetarit të Trupit bashkërendues ministrit Millan Markoviq, dokumentin e nënshkruan kryetari i komunës së Bujanocit Shaip Kamberi, kryetari i Partisë për veprim demokratik Riza Halimi, kryetari i Lëvizjes së progresit demokratik Jonuz Musliu, kryetari i Unionit demokratik shqiptar Mejdi Zeqiri, i ngarkuari i Partisë demokratike – Koalicioni “Për Serbinë europiane – Boris Tadiq” Sasha Peshiq dhe Stojançā Arsi në emër të grupit të qytetarëve “Dr. Stojançā Arsiq dhe dr. Miodrag Millkoviq”.

**b) Në fushën e ekonomisë** – në fillim të dhjetorit është mbajtur seanca e kryesisë së Trupit bashkërendues në të cilën ka marrë pjesë nënkryetarja e re, sekretarja shtetërore në Ministrinë për ekonomi dhe zhvillim regjional Dragijana Radonjiq – Petroviq. Është analizuar situata ekonomike në komunat Preshevë, Bujanoc dhe Medvegjë. Zgjidhja e problemeve ekonomike në këto komuna është çështje parësore e Trupit bashkërendues. Në pajtim me këtë është konstatuar se në fillim të 2011 të mbahet takim i ekonomistëve nga këto komuna me drejtoreshën e Fondit për zhvillim.

**c) Në fushën e investimeve infrastrukturore** – Me qëllim të fuqizimit të ekonomisë në komunat Preshevë, Bujanoc dhe Medvegjë, Trupi bashkërendues në vitin 2010 në projektet e infrastrukturës ka investuar 229.278.000,00 dinarë.

Në komunën e Preshevës janë investuar 91.948.590,00 dinarë për rekonstruimin e qendrës së qytetit, asfaltimin dhe rekonstruimin e rrugëve në fshatrat Leran, Miratoc, Cakanoc, Geraj, Rahovicë, Norçë dhe Bugarinë, afaltimi i rrugës lokale Zhunicë – Bushtran, rregullimi i shtratit të lumit në fshatin Raincë, rekonstruimin e rrugës fshatin Corroticë, rekonstruimin e sokaqeve në Stacionin hekurudhor, adaptimin e Shtëpisë së kulturës “Abdulla Krashnica” për nevojat e RTV Presheva dhe fakultetit si dhe për mbindërtimin e shkollës së mesme teknike “Presheva” në Preshevë.

Në komunën e Bujanocit janë investuar 100.341.068,00 dinarë për përmirësimin e furnizimit me rrymë elektrike në “Sektorin 6”, asfaltimin e rrugës në fshatin Bilaç dhe të rrugës Lluçan – Dobrosin, mirëmbajtja e përforcuar e rrugëve në fshatrat Drezhnicë, Sv. Petkë dhe Kushticë, ndërrimin e dyerve dhe dritareve në ShF “Branko Radiçeviq” dhe të ndërtimit të bllokut në ShM “Sezai Surroi” në Bujanoc, aktivitetet bujqësore dhe puna në rrjetin e ujësjellësit në Zhbevcë.

Në komunën e Medvegjës janë investuar 39.241.650,00 dinarë për ndërtimin e rrugës lokale Petrilë – Mërkonjë, për ndërtimin e korzosë në dy rrugë, ndërtimin e segmentit rrugor Medvegjë – Cërni Vërh dhe për mirëmbajtjen e rrugëve të lagjeve në territorin e kësaj komune.

Nga PNI janë ndarë 6.381.184,00 dinarë edhe atë për komunën e Preshevës 2.996.728,00 dinarë dhe për komunën e Medvegjës 3.384.456,00 dinarë.

**e) Në fushën e integritimeve** – Trupi bashkërendues në këtë periudhë ka shpallur dy konkurse për ndarjen e mjeteve për projektet e sektorit civil, ndihmë kategorive më të rrezikuara dhe për media. Komisionin për zgjedhjen e projekteve e përbëjnë nga një përfaqësues nga secila komunë dhe tre përfaqësues të Shërbimit të Trupit bashkërendues. Në konkurset e Trupit bashkërendues në këtë periudhë janë lejuar 9.844.028,73 dinarë për projektet e shoqërisë civile dhe 3.615.260,10 dinarë për informim. Numri i përgjithshëm i projekteve të cilat i ka mbështetur Trupi bashkërendues në këtë periudhë është 31.

Trupi bashkërendues në bashkëpunim me institucionet republikane, ka mundësuar hapjen e 62 vendeve të reja të punës në dogana, në administratën tatimore dhe në organet e inspeksionit. Ky është hap i madhë në integrimin e komuniteteve pakicë në jug të Serbisë ngase është krijuar mundësia për përfaqësimin e tyre në institucionet republikane.

Bursat për nxënësit e shkollave të mesme nga komunat Preshevë, Bujanoc dhe Medvegjë dhe mjetet për blerjen e paisjeve shkollore për nxënës fillestar nga këto komuna janë siguruar edhe për këtë vit.

Për kategoritë më të rrezikuara sociale Trupi bashkërendues secilës komunë i ka ndarë nga dy milion dinarë.

Trupi bashkërendues ka përkrahur formimin e Këshillit nacional të shqiptarëve i cili merret me çështjet e gjuhës, informimit, arsimit dhe kulturës së këtij komuniteti. Është vendosur bashkëpunimi në mes të Këshillit nacional të shqiptarëve dhe Trupit bashkërendues më së shumti në zgjidhjen e çështjeve të arsimit.

Në bashkëpunim me Mbrojtësin e qytetarëve, Trupi bashkërendues ka përkrahur hapjen e kësaj zyre në Preshevë, Bujanoc dhe Medvegjë.

**d) Në fushën e arsimit** - Është formuar Grupi i posaçëm punues për sigurimin e kushteve për hapjen e enteve të shkollimit të lartë në Preshevë dhe Bujanoc, i cili e ka për detyrë të përcaktoj mundësinë për hapjen e njësive të shkollimit të lartë në jug të Serbisë. Grupin e posaçëm punues e përbëjnë përfaqësuesit e Ministrisë së arsimit, Trupit bashkërendues, të Këshillit nacional të shqiptarëve, ekspertët vendor për çështje të arsimit të lartë dhe këshilltari i Komesarit të lartë për pakica nacionale pranë OSBE-së.

Për studentët shqiptar të cilët kanë regjistruar vitin e dytë të Fakultetit juridik dhe atij ekonomik të universiteti të Nishit në paralelet në Medvegjë, Trupi bashkërendues ka siguruar tekstet mësimore në gjuhën e tyre amtare.

**dh) Në mardhëniet ndërkombëtare** – Trupi bashkërendues fitoi mbështetjen e komesarit të lartë për pakicat nacionale pranë OSBE-së dhe të Ambasadës Britanike në Beograd për punën e grupit të posaçëm për sigurimin e kushteve rreth hapjes së enteve të shkollimit të lartë në Preshevë dhe Bujanoc.

Trupi bashkërendues ka nënshkruar kontratën me UNDP dhe është bërë implementues i njëjës komponentë në kuadër të Programit PBILD për zhvillimin inkluziv të cilin në bashkëpunim me vetadministratat lokale të Qarkut të Jabllanicës dhe të Pçinjës, agjencionet shtetërore, shoqërinë civile e zbatojnë agjencione të ndryshme të Kombeve të Bashkuara.

**e) Në komunikim me opinionin** – Shërbimi i Trupit bashkërendues në vazhdimësi e njofton opinionin mbi punën e tij duke publikuar tekste në prezentimet internetike të Trupit bashkërendues, i dërgon raportet mbi punën Qeverisë së Republikës së Serbisë, mediave dhe partnerëve ndërkombëtar.

## Aktivitetet kryesore të Trupit bashkërendues në periudhën e kaluar janë prezentuar në mënyrë kronologjike:

- **Përkrahja kooperativës multietnike** – Në fillim të qershorit kryetari i Trupit bashkërendues



Millan Marković e vizitoi fshatin Levosojë në Komunën e Buajnosit ku bisedoi me anëtarët e kooperativës multietnike “Jug Levosojë”. Me përbërjen e saj multietnike kjo kooperativë dëshmon se bashkëpunimi i shqiptarëve dhe i serbëve është i mundur. Kooperuesit në konkursin e Trupit bashkërendues kanë fituar mjete për riparimin e mekanizmit dhe të furnizimit me farëra për mbjelljet pranëverore.

Me qëllim të ngritjes së kapaciteteve për prodhimin e qumshtit në komunën e Bujanocit, ministri Marković i ka propozuar bujqëve bashkëpunimin me qumshtoren e Shabacit e cila do të jep laktofrizë për magazinimin e qumshtit.

Me nismën e Trupit bashkërendues dhe të Ministrisë së bujqësisë u organizuar takimi me pronarët e qumshtores nga Presheva dhe Bujanoci dhe se është vendosur bashkëpunimi në mes të kooperativës multietnike dhe të qumshtores lokale e cila merret me grumbullimin e qumshtit me çmim më të lartë se nga ai i deritanishmi.

- **Ndihmë personave me moshë të shtyer në Medvegjë** – Në fillim të korrikut është hapur shtëpia për qëndrim ditor për persona të paafte dhe të moshuar. Projekti në shumë prej afër tetë milion dinarësh është realizuar me mjetet e Ministrisë për punë dhe politikë sociale, Trupit bashkërendues të Qeverisë së Republikës së Serbisë për komunat Preshevë, Buajnoc dhe Medvegjë.

- **Artistët e rinjë shqiptar, rom dhe serb në festivalin muzikor “Egzit”** – Në bashkëpunim me Trupin bashkërednues, Qeveria e KA të Vojvodinës ka mundësuar qëndrimin në festivalin muzikor “Egzit” trupës teatrore multietnike që ekzekutuan pjesën teatrale “Ti dhe unë jemi ne”. Krahas biletave hyrëse për ditën e parë të festivalit, të gjithë pjesëmarrësve dhe bashkërenduesve të projektetit iu është siguruar qëndrimi në Novi Sad. Ky është vazhdim i një bashkëpunimi të mirë mes qeverisë së KA të Vojvodinës dhe Trupit bashkërednues, e cila financiarisht e ka mbështetur projektin “Ti dhe unë jemi ne”.

Projekti “Ti dhe unë jemi ne” u shëndrrua në qendër rinore me seli në Bujanoc, i cili ka realizuar projektin multietnik edhe me të rinjë nga Kikinda.

- **Kryetari i Trupit bashkërendues Ministri Millan Marković bisedoi me kryetarin e Këshillit nacional të shqiptarëve Galip Beqirin** – Kryetari i Trupit bashkërendues dhe kryetari i Këshillit



nacional të shqiptarëve janë takuar më 13 korrik në Bujanoc dhe biseduan mbi aktivitetet e planifikuara në bashkëpunimin e ardhshëm të Këshillit dhe të Trupit bashkërendues. Në konferencën për media pas takimit, kryetari i Trupit bashkërendues Millan Marković dhe kryetari i Këshillit nacional të shqiptarëve Galip Beqiri theksuan se problemi më i madh, zgjidhja e të cilit përkon me domenin e Këshillit nacional, pikërisht ai nga fusha e arsimit.

• **Janë ndarë mjetet në konkursin e Shërbimit të Trupit bashkërendues – Komisioni i Shërbimit të Trupit bashkërendues ka shpallur konkurs për realizimin e projektit të shoqatave të qytetarëve në komunat Preshevë, Bujanoc dhe Medvegjë.** Ky është konkursi i katërt i këtij Shërbimi qëllimi i të cilit është forcimi i kapaciteteve të sektorit civil në këto komuna.

Në konkurs kanë arritur gjithësejtë 38 propozim projekte ndërsa mjetet në shumë prej 4.893.727,00 dinarë u lejuan për realizimin e 13 projekteve.

Mjetet u ndanë për projektet të cilat merren me sigurimin e teksteve mësimore për fëmijët me gjendje të vëstitur materiale, edukimit në temën e tregëtisë me njerëz, teatrin dhe filmin, rregullimin e oborreve shkollore, monitorimin e raportimit medial dhe me traditat popullore.

• **Grupi i posaçëm punues për hulumtimin e mundësive të arsimit të lartë në jug të Serbisë –** Në



bazë të rekomandimeve nga Studimi i fizibilitetit dhe i vendimit të ministrit të arsimit Zharko Obradović dhe me nismën e Trupit bashkërendues u formuar Grupi i posaçëm punues i cili merret me sigurimin e kushteve për arsim të lartë në Preshevë dhe Medvegjë. Mbledhja konstituive është mbajtur në muajin korrik.

Grupin e posaçëm e përbëjnë përfaqësuesit e Ministrisë së arsimit, Trupit bashkërendues, Këshillit nacional të shqiptarëve, ekspertët e vendit për çështje të arsimit dhe këshilltari i Komesarit të lartë për pakicat nacionale. Detyra e këtij Komisioni është t'i përcaktoj mundësitë dhe përgatitjet e rekomandimeve lidhur me hapjen e njësisë së shkollimit të lartë në jug të Serbisë.

Në punën e deritanishme anëtarët e grupit punues kanë aprovuar rekomandimet lidhur me përcaktimin e fushës dhe të nivelit të studimeve, lokacionin e njësisë së ardhshme të shkollimit të lartë dhe kanë dhënë vlerësimin e numrit të studentëve. Për vitin e ardhshëm është planifikuar që për 80-100 student në Bujanoc të hapet paralelja Fakultetit Ekonomik të Universitetit të Nishit.

Për t'u njohur më shumë me përvojat dhe të fitojnë qasje në modelet e ndryshme të organizimit të shkollimit të lartë në mjediset multietnike, anëtarët e Grupit të posaçëm punues në fund të nëntorit ishin në vizitë triditore në Vojvodinë, që ishte organizuar në kuadër të Programit PBILD të Kombeve të Bashkuara. Anëtarët e Grupit të posaçëm vizituan edhe Shkollën e lartë të studimeve profesionale për arsimimin e edukatorëve (Novi Sad), Fakultetin ekonomik (Suboticë), Fakultetin e mësuesisë (Suboticë), Fakultetin filozofik (Novi Sad) dhe u takuan me Miroslav Vesković, rektor i Universitetit në Novi Sad dhe me sekretarin krahinor për arsim Zolltan Jegeshin. Të gjitha këto takime ofruan qasje në mënyra të ndryshme të organizimit të procesit arsimor në entet e larta shkollore, të cilat përcillen edhe me kornizën ligjore dhe të dispozitave pozitive në fuqi të Republikës së Serbisë, dhe se dhanë bazën për definimin e modelit më të mirë i cili mund të aplikohet në jug të Serbisë, në pajtim me mundësitë dhe nevojat.

Gjatë vizitës anëtarët e Grupit të posaçëm janë takuar edhe me përfaqësuesit e këshillave nacionale të hungarezëve, rumunëve dhe sllovakëve, me sekretarin krahinor për kulturë Millorad Gjuriqin, me mbrojtësin krahinor të qytetarëve Anik Mushkinj – Hajnrih, sekretarin krahinor për dispozita, administratën për pakica nacionale Andor Deliun dhe Aleksandër Vujiqin nga Qendra vojvodinase për të drejtat e njeriut.

Takimet e Grupit të posaçëm mbahen së paku një herë në muaj.



• **U hap qëndrimi ditor për fëmijët me nevoja të veçanta** – Shoqata e prindërve të fëmijëve dhe të rinjëve me nevoja të veçanta nga Presheva në korrik në këtë qytet ka hapur qëndrimin ditor për fëmijët me nevoja të veçanta, punën e të cilit e ka mundësuar Trupi bashkërendues. Në hapjen e qëndrimit ditor mori pjesë kryetari i Trupit bashkërendues Ministri Millan Marković i cili bisedoi me kryetarin e shoqatës Zejri Ymerin, edukatoren, fëmijët dhe prindërit e tyre të cilët shprehën kënaqësinë që fëmijëve të tyre i është mundësuar që të qëndrojnë jashtë shtëpisë, e që përmes shoqërimit me fëmijët e tjerë dhe krahas ndihmës së personave profesionaltë fitojnë njohuri dhe shkathtësi të reja. Në shenjë faleminderimi, fëmijët i dhuruan ministrit Marković vizatime, ndërsa kryetari i shoqatës i dorëzoi ministrit mirënjohjen për mbështetjen e deritanishme.

• **Fëmijëve iu dorëzuan paisjet shkollore nxënësve fillestar** – Për 1200 nxënës fillestar të komunave Preshevë, Bujanoc dhe Medvegjë, Trupi bashkërendues iu siguroi paisjet shkollore në vlerë prej 3.5 milion dinarë. Ministri Marković së bashku me kryetarët e komunave të Preshevës, Bujanocit dhe Medvegjës si dhe me kryetarin e Këshillit nacional të shqiptarëve këtë donacion ia dorëzuan nxënësve fillestar të shkollave fillore “Nëntë maji” dhe “Vuk Karaxhiq” në komunën e Preshevës dhe Muharrem Kadriu” dhe “Dragomir Trajković” në komunën e Bujanocit. Me rastin e ndarjes së kësaj dhurate të çmuar kryetari i Trupit bashkërendues iu drejtua fillestarëve në gjuhën serbe dhe shqipe, duke iu dëshiruar shumë fat dhe sukses në shkollim.



• **U hap terreni sportiv dhe kuzhina për nxënës në Levosojë** – Kryetari i Trupit bashkërendues ministri Millan Marković në fillim të shtatorit në fshatin levosojë (komuna e Bujanocit) në shkollën fillore “Vuk Karaxhiq” në Levosojë hapi terrenin sportiv dhe kuzhinën për nxënës. Mjetet për ndërtimin e terrenit u siguruan nga “Telekomi” ndërsa kuzhina u pais NP PTT komunikacioni i Serbisë. Në hapjen e terrenit sportiv ishte i pranishëm edhe kryetari i Komunës së Bujanocit Shaip Kamberi i cili mbështeti aksionin e Trupit bashkërendues.

• **U hap qendra e rikonstruuar e Preshevës** – Kryetari i Trupit bashkërendues ministri Marković, ministri jorezident Sulejman Uglanin dhe këshilltari i lartë i drejtorit të Misionit të USAID-it në Serbi Art Fllanagan, më 21 shtator hapën qendrën e rikonstruktuar të Preshevës në të cilën janë investuar 43 milion dinarë. Me pllaka janë shtruar trotoret, janë vendosur ulëse dhe fontana, janë ndërruar gypat e ujës-jellësit dhe të kanalizimit. Kryetari i komunës së Preshevës Ragmi Mustafa iu dorëzoi mirënjohje të komunës investitorëve të cilët mundësuan që Presheva të ketë qendrën e qytetit çfarë edhe e meriton. Marković, Mustafa, Uglanini dhe Fllanagan mbollën dy fidane në qendrën e rregulluar të Preshevës.

• **U mbajt seanca e Kryesisë së Trupit bashkërendues** – Të hënën më 4 tetor është mbajtur seanca e kryesisë së Trupit bashkërednues. Kryetari i tij ministri Millan Marković foli për ngjarjet më të rëndësishme në periudhën mes dy seancave dhe në veçanti foli për rezultatet e punës së trupit bashkërendues në tetë muajt. Si e arritur më e rëndësishme e Trupit bashkërendues në këtë periudhë ministri Marković e përmendi formimin e Këshillit nacional të shqiptarëve, marrëveshjen rreth hapjes së maternitetit në Preshevë dhe të njësisë së shkollimit të lartë në Bujanoc, lejimi i Qeverisë për rritjen e numrit të të punësuarëve nga komunat e jugut të Serbisë në entet republikane, puna dhe bashkëpunimi i suksesshëm me sektorin e shoqërisë civile si dhe realizimi i më shumë projekteve të rëndësishme të cilat janë orientuar në përmirësimin e jetesës para së gjithash të të rinjëve në këto komuna. Krahas kësaj janë ndarë mjete mësimore dhe çanta për nxënësit fillestar dhe është hapur qendra e rregulluar në Preshevë.

Si prioritetet e Trupit bashkërendues ministri Markoviq i ka përmendur integrimin dhe përmirësimin e kushteve të jetës së përbashkët të të gjithë qytetarëve në jug të Serbisë. Mirëkuptimi, toleranca dhe durimi janë bazë e domosdoshme e çdo shoqërie multietnike dhe vetëm se krahas tyre mund të arrihen paqja, stabiliteti dhe jeta më kualitative, thanë anëtarët e kryesisë së Trupit bashkërendues.

• **Hapja e paraleles multietnike të fakultetit në Bujanoc** – Të mërkurën më 6 tetor në Bujanoc



u mbajt konferenca për media në të cilën folën kryetari i Trupit bashkërendues Millan Markoviq, komesari i lartë i OSBE për pakicat nacionale Knut Vollebek dhe ndihmësi i ministrit të arsimit Zoran Kostiq. Konferenca është mbajtur pas takimit të Grupit të posaçëm punues i cila aprovoi rekomandimin lidhur me lokacionin dhe profilin e fakultetit të ardhshëm. Ministri Markoviq publikoi se rekomandimi i Grupit të posaçëm punues është që në vitin e ardhshëm akademik në Bujanoc të hapet paralelja e fakultetit ekonomik të Universiteti të Nishit. Ky ent do të hapet për qytetarët e të gjitha nacionaliteteve.

• **Aksioni grafitet në Bujanoc** – Qendra për tolerancë dhe integrim të jugut të Serbisë në fillim të



tetorit organizoi aksionin gjithëditor të vizatimit të grafitëve. Ky aktivitetet është pjesë e projektit “Unë e dua Bujanocin” të cilin e ka përkrahur Trupi bashkërednues në konkursin për programet dhe projektet e shoqatave të qytetarëve.

Me qëllim të promovimit të punës së tyre, të rinjtë nga Bujanoci, aktivistë të kësaj shoqate, i ftuan vizatuesit profesionistë të grafitëve të cilët në murin e një ndërtese në qendër të qytetit shkruan “Unë e dua Bujanocin”. Bujanocasit e rinjë u bashkuan në këtë nismë dhe i dhanë vulën e vet grafitit të ri duke shënuar aty emrat e tyre. Paralelishtë me vizatimin e grafitit në qendër të Bujanocit nga një video link shfaqeshin me radhë fotografitë e aksioneve të deritanishme publike në kuadër të projektit “Unë e dua Bujanocin”.

Aksionin e mbështetën edhe përfaqësuesit e vetadministrimit lokal.

• **U nënshkrua marrëveshja mbi qeverisjen multietnike në Bujanoc** – Kryetari i Trupit



bashkërendues ministri Millan Markoviq më 21. tetor së bashku me përfaqësuesit politik të shqiptarëve dhe serbëve nënshkroi marrëveshjen mbi formimin e qeverisjes multietnike në komunën e Bujanocit. Krahas Markoviqit dokumentin e nënshkruan kryetari i komunës së Bujanocit Shaip Kamberi, kryetari i Partisë për veprim demokratik Riza Halimi, kryetari i Lëvizjes së progresit demokratik Jonuz Musliu, kryetari i Unionit demokratik shqiptar Mejdi Zeqiri, i ngarkuari i Partisë demokratike – koalicioni “Për

Serbinë europiane Boris Tadiq” Sasha Peshiq dhe Stojanča Arsiq në emër të grupit të qytetarëve “Dr. Stojanča Arsiq dhe dr. Miodrag Millković”.

Sipas kësaj marrëveshje pushteti në komunën e Bujanocit do të përbëhet krahas koalicionit të deritanishëm të tri partive shqiptare edhe prej dy partive politike dhe një shoqate qytetarësh, të komunitetit serb. Pushtetin në Bujanoc do ta përbëjnë Partia për veprim demokratik me 13 këshilltar, Lëvizja e progresit demokratik me 6 këshilltar, Unioni demokratik shqiptar me 3 këshilltar. Tre këshilltar i ka koalicioni “Për Serbinë europiane Boris Tadiq” (2 PD dhe 1 G17 plus) si dhe grupi i

qytetarëve “Dr. Stojanča Arsiq dhe dr. Miodrag Millkoviq”.

Me rastin e nënshkrimit të marrëveshjes ishte i pranishëm edhe shefi i Misionit të OSBE-së në Serbi Dimitris Kipreos.

Marrëveshja është edhe një bazë për zgjidhjen e çështjeve jetike të shqiptarëve, serbëve dhe romëve në Bujanoc.

- **Takimi me shfrytëzuesit e mjeteve të Trupit bashkërednues** – Shërbimi i Trupit bashkërednues organizoi takim me përfaqësuesit e shoqatave të qytetarëve dhe të organizatave joqeveritare të cilat fituan mjete në konkursin e Shërbimit. Takimi u organizua me qëllim të analizimit të aktiviteteve në kuadër të mjeteve të lejuara dhe të shqyrtimit të problemeve me të cilat ballafaqohet sektori civil në realizimin e aktiviteteve të projekteve. Ky është takimi i tretë i Shërbimit të Trupit bashkërednues dhe i shfrytëzuesve të mjeteve. Shërbimi i Trupit bashkërednues edhe në të ardhmen do të organizoj takime të këtilla, me qëllim të një informimi më të mirë në realizimin e projekteve, shpenzimin e mjeteve buxhetore dhe me qëllim të komunikimit më të mirë mes donatorëve dhe të shfrytëzuesve të mjeteve.

- **Nga jugu në veri** – Qendra rinore nga Bujanoci “Ti dhe unë jemi ne” ka punuar me të rinjtë nga Kikinda, Bujanoci dhe Presheva në shfaqjen teatrale “Ne jemi e tërë bota”. Ka fundi i tetorit premiera e shfaqjes u ekzekutua në Teatrin popullor të Kikindës me ekzekutim të nxënësve të shkollave të mesme pjesëtar të komuniteteve të ndryshme nacionale nga ky qytet.



Koncepti i këtij spektakli teatral i bazuar në fragmentet e dramës së Shekspirit “Romeo e Xhulieta”, u begatua edhe më shumë

nga përvojat e tinxherëve, të përkatësive të ndryshme nacionale, të cilët aktrojnë në gjuhën e tyre amtare.

Qendra rinore “Ti dhe Unë jemi Ne” të njëjtën shfaqje e ka përgatitur me nxënësit e shkollave të mesme nga Presheva dhe Bujanoci. Katërmbëdhjetë nxënës të shkollave të mesme shqiptar, serb dhe rom, në fillim të dhjetorit në sallën e stërmbushur të Shtëpisë së kulturës në Bujanoc dëshmuar se është e mundur një botë ndryshe. Gjatë 90 minutash të shfaqjes këta të rinjtë treguan se shoqërimi, dashuria, toleranca janë ato nyje të cilat i lidhin ata mes veti dhe i bëjnë më fatlum. Aktorët e shfaqjes nga Kikinda erdhën në premierë t’i mbështesin shokët e tyre nga Presheva dhe Bujanoci.

Në mesin e dhjetorit në teatrin Popullor në skenën “Rasha Pllaoviq”, publiku beogradas ka pasur rastin të merr pjesë në ekzekutimin e shfaqjes teatrale, në të cilën së bashku aktruan të rinjtë nga Kikinda, Bujanoci dhe Presheva, duke aktuar në 8 gjuhë të ndryshme.

Tinxherët nga Presheva dhe Bujanoci kah fundi i nëntorit ishin musafir të Ministrisë së punëve të jashtme dhe të Ministrisë së mbrojtjes të Republikës së Sllovenisë. Nxënësit e Gjimnazit “Lledina” dhe “Viç” ku u shfaq pjesa teatrale “Ne jemi e gjithë bota”, iu bënë një mikëpritje të ngrohtë bashkëmohatarëve të tyre nga Bujanoci dhe Presheva, duke i mirëpritur ata me duartrokitje frenetike. Në shfaqjen premier të ekzekutuar në Slloveni ishin të pranishëm Ambasadori i Republikës së Serbisë në Slloveni Predrag Filipov dhe përfaqësuesit e Trupit bashkërednues. Nikoqirët e fëmijëve nga jugu i Serbisë, Ministria e punëve të jashtme dhe ajo e Mbrojtjes së Sllovenisë ofruan edhe pjesën



turistike të programit për musafirët e rinj: vizita dhe njohja e objekteve monumentale dhe të traditës të Lublanës, vizitës në Bled, Kranj dhe Postojnë.

Shfaqjen e përkrahën Sekretariati krahinor për kulturë i Krahinës autonome të Vojvodinës dhe Trupi bashkërendues i Qeverisë së Republikës së Serbisë për komunat Preshevë, Bujanoc dhe Medvegjë.

• **Bursistët e Trupit bashkërendues vizituan Beogradin** - Trupi bashkërendues në korrik ka



shpallur konkursin për ndarjen e bursave për nxënësit e shkollave të mesme nga Presheva, Bujanoci dhe Medvegja. Në konkurs u paraqitën 335 nxënës – 119 nga Presheva, 113 nga Bujanoci dhe 103 nga Medvegja, ndërsa 206 nxënësve bursat iu ndanë në shtator të vitit 2010. Përparësi me rastin e ndarjes së bursave kanë pasur fëmijët pa një ose dy prindër. Komisioni për ndarjen e bursave është kujdesur edhe mbi gjendjen sociale të prindërve dhe /ose kujdestarëve si dhe për suksesin në vitin e mëparshëm shkollor. Në

pajtim me këtë janë ndarë bursat edhe atë: 85 nxënësve nga Presheva, 72 nxënësve nga Bujanoci dhe 49 nxënësve nga Medvegja. Secili nxënës do të merr 6.000 dinarë në muaj deri në fund të vitit shkollor, gjegjësishtë deri në qershor të vitit 2011. Ky është viti i dytë i ndarjes së bursave të nxënësve nga këto komuna me qëllim të nxitjes së integritimit, paqes dhe stabilitetit në komunat në jug të Serbisë.

Trupi bashkërendues për 206 nxënës të shkollave të mesme në nëntor organizoi vizitë në Beograd. Së bashku me nxënësit në vizitë do të jenë edhe përfaqësuesit e shkollave të tyre të mesme, kryetarët e komunave Preshevë dhe Bujanoc Ragmi Mustafa dhe Sllobodan Drashković dhe deputeti popullor Riza Halimi. Në praninë në “Pallatin Serbia”, në praninë të zyrtarëve të Qeverisë së Republikës së Serbisë dhe të përfaqësuesve të bashkësisë ndërkombëtare, u organizua pritje për nxënësit ga jugu i Serbisë në të cilin solemnishtë iu dorëzuan kontratat mbi bursat nga ana e kryetarit të Trupit bashkërednues ministri Marković, ministri i arsimit Zharko Obradović dhe deputeti popullor Riza Halimi.

Goran Qiriq, drejtori gjeneral i NP Posta e Serbisë bursistëve të Trupit bashkërendues i dorëzoi dhurata, ndërsa Sërgjan Cekiq, kryetar i këshillit të Kursimores postare iu dorëzoi libra kursimesh me depozitë në shumë me nga 5.000 dinarë.

Gjatë vizitës në Beograd bursistët biseduan me kryetarin e Serbisë Boris Tadiqin, vizituan Shtëpinë e Kuvendit popullor në të cilën i pranoi kryetarja e Kuvendit Sllavica Gjuković-Dejanović, ndërsa në objektin e Pallatit të vjetër u takuan me prefektin e Beogradit Dragan Gjillasin.

Nëntëmbëdhjetë vjeçarja Dafina Aliu nga Bujanoci i dhuroi kryetarit të Republikës së Serbisë dhe prefektit të Beogradit revistën e parë multietnike “Viva Bu” të qendrës rinore “Ti dhe unë jemi ne” të cilin së bashku e kishin përgatitur fëmijët shqiptar, rom dhe serb.

• **Konkursi i Trupit bashkërendues për financimin e projekteve në Preshevë, Bujanoc dhe Medvegjë** – Shërbimi i Trupit bashkërendues në tetor publikoi konkursin e tretë për programe dhe projekte në vitin 2010. ky njëherit ishte edhe konkursi i tretë i dedikuar shoqatave të qytetarëve dhe i pari konkurs për shërbimet e informimit. Numri i propozimeve të arritura në këtë konkurs ishte 52. Nga buxheti u ndanë 4.950.301,73 dinarë për projektet e përkrahjes së sektorit civil dhe 3.615.260,10 dinarë për shërbimet e informimit. Shërbimi i Trupit bashkërendues mbështeti 12 projekte të shoqatave të qytetarëve dhe 6 të mediave.

• **Premiera e filmit “Më kap nëse mundesh”** – Organizata multietnike “The future” nga Tërnoci të martën më 30 nëntor para qytetarëve të Bujanocit shfaqti premierën e filmit të metrazhit të gjatë “Më kap nëse mundesh” /“Catch me if you can”. Filmi është pjesë e projektit “Së bashku për buzëqeshje” i cili fitoi mbështetjen e Trupit bashkërendues për projekte.

Kjo organizatë pas vetes ka tashmë një film të metrazhit të shkurtër, i cili merret me promovimin e jetës së shëndosh.

Në filmin “Më kap nëse mundesh” /“Catch me if you can” luajnë të rinjët shqiptar, rom dhe serb. Qëllimi i filmit i cili në thelb është një komedi, është përmirësimi i komunikimit mes të rinjëve në jug të Serbisë. Filmi paraqet jetën e përbashkët dhe shoqërimin e të rinjëve të të gjitha nacionaliteteve. Porosia është e qartë: dallimet gjuhësore nuk janë qenësore ngase artistët në film komunikuan në gjuhën amtare por edhe në atë angleze.

Në premierën e filmit erdhën më shumë se 650 qytetarë të Bujanocit. Është e qartë se projektet e tilla janë të domosdoshëm ngase ndikojnë në përmirësimin e raporteve në mes të pjesëtarëve të të gjitha komuniteteve që jetojnë në komunën e Bujanocit.

• **Seanca e kryesisë së Trupit bashkërendues** – Në fillim të dhjetorit u mbajt seanca e kryesisë së Trupit bashkërendues e cila iu kushtua situatës ekonomike në komunat Preshevë, Bujanoc dhe Medvegje.

Nënkryetarja e Trupit bashkërendues Dragijana Radonjiq – Petroviq organizoi takim me ekonomistët nga komuna e Preshevës, Bujanocit dhe Medvegjës me drejtoreshën e Fondit për zhvillim, selia e të cilit është zhvendosur në Nish. Në takim me përfaqësuesit e Fondit për zhvillim ekonomistët e jugut të Serbisë do të kenë rastin të ndëgjojnë se në cilën mënyrë mund të konkurojnë për ndarjen e mjeteve të Fondit.

• **Ndarja e bursave për studentët e Fakultetit ekonomik dhe juridik në Medvegje** – Në vitin akademik 2010/2011 në paralelen, e Fakultetit ekonomik të Universitetit të Nishit, në Medvegje janë regjistruar 32 studentë, ndërsa në atë juridik 45 brucosh. Vitin e dytë të Fakultetit ekonomik nga 19 student sa kishte në vitin e parë e kanë regjistruar 12 sish, ndërsa atë juridik e kanë regjistruar 25 nga 35 studentë që kishte në vitin e parë. Të gjithë studentëve të cilët e kanë regjistruar vitin e dytë të këtyre fakulteteve Trupi bashkërendues iu dorëzoi nga një bursë emergjente në shumë prej 7.000 dinarësh.

Republika e Serbisë Trupi Koordinues për komunat  
Bujanoc, Preshevë dhe Medvegje

Tel: 011 21 20 906  
011 21 20 907  
Faks: 011 21 20 909

E-mail: office@kt.gov.rs